



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës

Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Referenca : 626/22/004/236

Në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, Rregullave dhe udhëzuesit të Prokurimit Publik-NDRYSHIM / PLOTESIMIT të Rregullores dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik A01 neni 4 pika (a) dhe në bazë të Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave të rregullores së Prokurimit Publik, nenin 8 paragrafi 8.1 nënparagrafi 8.1.1 pika (iii) bie këtë :

V E N D I M

I

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për Rishqyrtim e Operatorit Ekonomik – “Lekaj.ING” SHPK - PRISHTINË e parashtruar në mënyrë elektronike përmes platformës me datën 11.02.2022 për aktivitetin e prokurimit me nr. 626-22-574-2-3-6 dhe nr. të brendshëm: 626-22-004-2-3-6 me titull “HARTIMI I PROJEKTEVE IDEORE DHE ATYRE KRYESORE TË KOMUNËS SË MAMUSHËS PËR VITIN 2022”

II

Hiqet pezullimi i aktivitetit të prokurimit për procedurën në fjalë i publikuar me datën: 14.02.2022

III

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik “Lekaj.ING” SHPK – Rr.Xheladin Hana nr.35, PRISHTINË më datën 11.02.2022 ora 14:45 përmes platformës elektronike, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim mbi njoftimin për kontratë dhe dokumentet përcjellëse të tenderit, përkatësisht me vlerën e paraparë të kontratës për aktivitetin e prokurimit “HARTIMI I PROJEKTEVE IDEORE DHE ATYRE KRYESORE TË KOMUNËS SË MAMUSHËS PËR VITIN 2022”.

Si autoritet kontraktues pas pranimit brenda afatit ligjor me kujdes të shtuar e kemi shqyrtuar kërkesën për rishqyrtim duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 8.1 pika 8.1.1 të rregullores për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe

vlera e tarifave te ankesave kemi vendosur për refuzimin e kërkesës të parashtruar nga O.E "Lekaj.ING" SHPK-Rr. Xheladin Hana nr.35, Prishtinë, ka paraqitur pretendime të pa bazuara si më poshtë.

O.E ka cekur në pretendimin e parë se kinse Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të dispozitave të LPP konkretisht të nenit 7 ku ne si AK mendojmë që është e pabazuar pasi që kemi aplikuar barazinë pasi që tenderi ka qenë publik kemi trajtuar dhe do të vazhdojmë ti trajtojmë të barabartë të gjithë tenderuesit.

Ndërsa në pretendimin e dytë të O.E është se AK ka bërë shkelje të LPP-s konkretisht të nenit 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderit. Procedura në fjalë është në fazën e publikimit dhe në fazën e tenderimit nga operatorët ekonomik, andaj mendojmë që nuk kemi bërë shkelje të këtij neni.

Te nderuar ne si autoritet kontraktues jemi te thirrur dhe kemi kompetenca që në rast të shpalljes, hapjes, vendimit për tender, të konsultohemi me legjislacionin në fuqi e cila rregullon fushën e Prokurimit. Edhe në këtë rast kemi ndjekur të gjitha hapat e kërkuara nga LPP-ja duke zbatuar nenin 9. Gjatë procedurës së inicimit të aktivitetit të prokurimit, vlerësimit të vlerës së përcaktuar për tu kryer këto projekte (shërbime) jemi bazuar në çmimin e shërbimeve të vitit të kaluar (2021), ku janë kryer të gjitha shërbimet me çmim më të ulët se vlera e paraparë për kontratën e ngjashme e që ka qenë 3,500.00 €. Kontrata për shërbimet e ngjashme vitin e kaluar, është nënshkruar për një vlerë prej 2,624.80€ dhe të gjitha shërbimet janë kryer sipas asaj kontrate me nr. të prokurimit 626-21-1182-2-3-6.

Andaj mendojmë që pretendimet të parashtruara nga O.E asesi nuk janë të bazuara sepse sa i përket pretendimeve që kinse kemi shkelur nenin 7 dhe 59 të LPP-s dhe vlerën e parashikuar të kontratës pasi që për këto shërbime janë paraparë çmimet e tregut dhe absolutisht provat tregojnë se Autoriteti Kontraktues ka respektuar në përpikëri të gjithë procedurën e prokurimit e që aspak nuk mendojmë që kemi bërë shkelje të LPP-s dhe RROUP në analizimin dhe vlerësimin e çështjeve të cilat ju i keni theksuar.

Andaj,

Me qenë se Operatori Ekonomik kërkesën për rishqyrtim e ka bërë duke mos pasur kurrfarë baze juridike në parashtrimin e kërkesës u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Mamushë, 14.02.2022

Gazmend Gashi
Udhëheqësi i sektorit të prokurimit
Komuna Mamushë



Këshilla juridike: Kundër këtij vendimi pala e paknaqur mund të parashtoj ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

